



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE “XHAFERR KONGOLI” ELBASAN

Data 26.09.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**Objekti: “BLERJE MATERIALE ORTOPEDIKE DHE TRAUMATOLOGJIKE”-
Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me
afat 12 muaj .**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Furnizime ortopedike 33141700-7

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4,324,102 (kater milion e treqind e njezet e kater mije e
njqind e dy) leke pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Vlore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

- b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;*
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% i fondit limit të përlllogaritur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Faturat të jenë të deklaruar në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës"

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

2.3.2 OE duhet te vetedeklaroje origjinen e mallit dhe kompanine prodhuese (te plotesohet ne shtojcen 1), oferta ekonomike.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3 OE duhet te jete i certifikuar me ISO 9001:2015/ose/ekuivalent. Per kete ai duhet te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.4 Ofertuesi duhet te paraqesi Certifikate konformiteti sipas direktives MDD 93/42 EEC (te perditesuar)/ ose FDA ose ekuivalent, per te gjithë artikujt e ofruar, te perkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.5 “OE duhet te paraqese autorizim per tregtim te paisjeve mjekesore, te leshuar nga MSHMS sipas ligjit 89/2014 “Per Paisjet Mjekesore”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të vërtetuar që operatori vepron sipas legjislacionit ne fuqi bazuar në nenin 40, pika 8 te VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar.

2.3.6 Ofertuesi duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi i mallrave per lejimin e tregtimit te artikujve te tij, te perkthyer dhe noterizuar. OE mund te paraqesin autorizim të lëshuar edhe nga distributori i autorizuar. Per te vertetuar autorizimin e lëshuar nga distributori i autorizuar, OE duhet te vertetoje me dokumentacion lidhjen ndermjet Prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshne për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.7 Kataloge per te gjithë artikujt e ofruar ku te perfshihen edhe specifikimet teknike per secilin artikull. OE duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do te pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;

2.3.8 Per te vertetuar qe OE i permbushin specifikimet teknike dhe jane ne gjendje te realizojne me sukses kontraten, duhet qe te paraqesin mostra per te gjithë artikujt, sipas tabelës ne specifikimet teknike dhe sipas katalogjeve perkatese te prodhuesit.

- OE ofertues duhet te paraqesin nga nje moster per cdo artikull.

- Mostrat duhet te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se tenderit.

- Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Elbasan, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a. Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës.

- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës. Do te skualifikohen OE ne rast se nuk paraqiten dhe/ose mostrat e paraqitura nuk jane sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

2.3.9 OE duhet të paraqesin një deklaratë ku të shprehet se do të vendosi në dispozicion të Ak, për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumi një set montimi) dhe të paktën një specialist të trajnuar për përdorimin e seteve. Në deklaratë duhet të tregohet emri i specialistit dhe duhet bashkelidhur certificate/dëshmi të leshuar nga kompania prodhuese të seteve që të provojnë trajnimet e tij.

2.3.10 OE duhet të paraqesin një deklaratë ku të shprehet se do të vendosi në dispozicion të Ak, certifikatat e origjines së mallit (implanteve) dhe certifikatat e regjistrimit të mallit pranë Institucioneve perkatëse në RSH. Certifikatat duhet të shoqërojnë mallin sipas kontratave të furnizimit që do të nënshkruhen përgjate periudhës 12 muajore

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të vërtetuar që malli i ofruar përmbush specifikimet teknike, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 6, gërma a, b, të VKM 285 datë 19.05.2021. (Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në seksionin e specifikimeve teknike, *komisioni* vendosi te njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas procesverbalit të hartuar nga komisioni I identifikimit të nevojave dhe hartimit të specifikimeve teknike në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

GRUPI	ARTIKULLI	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	Komponenti Femoral pa cement	Stemi femoral duhet te jete me dy lloje offset: standart dhe i lateralizuar ; Seria te kete se10 permasa per stemin standart dhe 10 permasa per stemin e lateralizuar me nje gjatesi 132 mm deri ne 160 mm me nje devijacion maksimal +/- 5%; Komponenti femoral te kete perberje Titanium alloy, te kete te aplikuar plasma spray porous-coating e cila siguron fiksimin afat gjate te komponentit me kocken dhe/ose cdo material tjetër ekuivalent i cili realizon funksionin per produktin e kerkuar.Konusi i qafes duhet te jete 12/14 dhe stemi te kete nje kend cerviko-diafizar 132 ose 133 grade me nje devijacion +/- 5%; Stemi duhet te jete pa kollare dhe ne majen e tij duhet te kete nje vrime te filetuar per te lejuar sigurin ne implantimin e tij dhe gjithashtu per ekstraktimin ne rast revizionimi. Forma e stemit femoral pa cement te jete e njejte me formen e stemit me cement ne menyre qe mjeku mund te nderroje sistemin me cement ose pa cement gjate kohes se operacionit.
2	Komponenti Femoral me cement	Stemi femoral me cement duhet te jete me dy offsete: standart dhe i lateralizuar,te kete perberje co-cr dhe/ose cdo material tjetër ekuivalent i cili realizon funksionin per produktin e kerkuar. Konusi i qafes te jete 12/14 dhe kendi cerviko diafizar te jete 132 ose133 grade me nje deviacion +/- 5%; . Stemi femoral duhet te kete 6 permasa me nje gjatesi 135mm deri ne 160mm me nje devijacion maksimal +/-10%. Ne majen e tij te kete nje vrime dhe/ose cdo material tjetër ekuivalent i cili realizon funksionin per produktin e kerkuar.Forma e stemit femoral me cement te jete e njejte me formen e stemit pa cement ne menyre qe mjeku mund te nderroje sistemin me cement ose pa cement gjate kohes se operacionit.

3	Komponenti acetabular pa cement	<p>Shelli te kete perberje titanium alloy dhe te kete te pakten 13 permasa qe fillojne nga 40 mm deri ne 64 mm .Te kete te aplikuar plasma spray porus-coating e cila siguron fiksimin afatgjate te komponentit me kocken dhe/ose cdo material tjeter ekuivalent i cili realizon funksionin per produktin e kerkuar. Te kete tre vrima periferike dhe nje qendrore ne pjesen e brendshme te cilat sherbejne per fiksimin e komponentit me kocken ne saje te vidave ku rrisin stabilitetin primar. Te kete te pakten 3element sigurie fiksimi ku te pakten njera prej tyre te jene vidat.Polietileni perkates i komponentit acetabular duhet te jete tre llojesh: standart,antiluxim(10 grade /20 grade) dhe me bregore (me buze, me kapuc ose me vesh). Diametri i tij i jashtem duhet ti pershtatet diametrit te brendshem te shellit kurse diametri i brendshem i polietilenit duhet te jete 22mm dhe/ose 28mm dhe/ose 32mm me nje deviacion maksimal +/- 10% . Komponenti acetabular duhet te shoqerohet me vida perkatese qe fillojne nga 15-50 mm me nje devijacion maksimal +/-10%.</p>
4	Kokat Femorale	<p>Kokat Femorale te jene me perberje CoCr , ose qeramike, ose cdo material tjeter ekuivalent I cili realizon funksionin per produktin e kerkuar. Koni I brendshem te jete 12/14 .Diametri duhet te jete 22 mm me te pakten 3permasa small,medium,large dhe 28 mm dhe 32 mm me te pakten 4 permasa small,medium,larg, extralarge me nje deviacion maksimal +/-10%.</p>
5	Koka Bipolare	<p>Perberja e siperfaqes se kokes bipolare te kete perberje Co-Cr dhe/ose cdo material tjeter ekuivalent qe realizon funksionin per produktin e kerkuar. Seria te filloje nga numri 41mm dhe te vazhdoje ne menyre lineare deri ne numrin 61 mm me nje devijacion maksimal +/-10%.</p>
6	Cementi Kockorë	<p>Cementi per kocken duhet te jete ne paketime nga 40 g dhe te jete ne variantet: te kete ne perberje te tij nje antibiotik te tipit gentamicine ,dhe/ose cdo material tjeter ekuivalent i cili realizon funksionin per produktin e kerkuar ,dhe /ose te jete pa antibiotik ne rast se pacienti eshte alergjik nga antibiotiku. Afati i skadences ti kaloje 1 (nje) vite.</p>

7	Shtifte Femori	Te jene me perberje titaniu. Duhet te jene permasa nga 9 mm-12 mm gjeresi dhe per secilen permase te kete permase ne gjatesi ,qe fillohet nga 320 mm deri ne 460 mm me devijacion +/- 12%. Te jene i shoqeruar me vidat proksimale dhe distale sipas sistemit perkates. Te jene i shoqeruar dhe me tapen fundore.
8	Shtifte Tibie	Te jene me perberje titaniu. Duhet te jene permasa nga 8 mm-11 mm gjeresi dhe per secilen permase te kete permase ne gjatesi ,qe fillohet nga 280 mm deri ne 375 mm me devijacion +/- 10 %. Te jene i shoqeruar me vidat proksimale dhe distale sipas sistemit perkates Te jene i shoqeruar dhe me tapen fundore.
9	DHS/ DCS	Pllake DHS/DCS jo locking me kende 95, 130, 135, 140,145,150 grade me gjatesi variabel nga 48mm-370mm me deviacion +/- 5%. Gjatesia e vides qendrore te varioje nga 50mm-150mm me deviacion +/-5%. Pllaka duhet te jene e vlefshme per kontakt te limituar. Vida kompresive me gjatesi 32 mm dhe/ose 25mm
10	Fiksator ekstern multiaxial me klamp	e)Fiksator Kerciri
11	Pllake anatomike humeri proksimal (locking)	Pllake anatomike proksimale humeri locking e majte /e djathte per vida 3.5mm/4.00mm me 4 deri 10 vrima kortikale me gjatesi 94 mm- 160 mm deviacion +/-5%
12	Shtiza Kirschner	Shtiza Kirshner 1.6 mm dhe te jene ne me dy gjatesi 150 mm e 300 mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.

13	Shtiza Steinman	Shtiza Steinman te jene ne tre permasa ne diameter 2.4mm, 3.2mm e 4.0mm e gjatesi nga 200 mm ne 300 mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.
----	-----------------	--

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Afati i skadencës: data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës. Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh. Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedure prokurimi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

Në lidhje me *kushtet e veçanta për kualifikim*, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :

Data: 09.10.2023 Ora: 10:00

NJESIA E PROKURIMIT